

A4-0881-3/15
Data: 23.03.2015

KOLEGJI AAB
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

Programi master: Politikat sociale dhe mirëqenia e fëmijëve
Kandidati: Bejtije Muja
Titulli i temës: Rëndësia e bashkëpunimit të familjes me institucionet parashkollore
Propozimi për mentor: Prof. Dr. Naser Zabeli

Lënda: Kërkesë për lejimin e punimit të diplomës, tezat dhe projekt temën e masterit

Përshkrimi i shkurtër i temës:

Mosha parashkollore shënon përjetimin e parë të fëmijës larg familjes. Dëshira e fëmijëve është që të rriten dhe të arrijnë gjithqka me fuqitë e veta, por për këtë i duhet dashuria, kujdesi e siguria. Andaj shtylla ku ata mbështeten janë prindërit dhe edukatorët e tyre. Bashkëpunimi i këtyre dy faktorëve do të krijoj shanse për zhvillimin dhe njohjen e personalitetit të fëmijës.

Ky studim i imi për përgaditje të temës së diplomës do të ketë për qëllim të identifikojë çështjet që kanë të bëjnë me rëndësinë e bashkëpunimit të familjes me institucionet parashkollore, me synim që këta faktorë të hartojnë politika për përmirësimin e bashkëpunimit mes tyre.

Disa prindër mund të kenë përvojë negative nga kopshti, e disa të tjerë thonë se 'edukatorja i din të gjitha që është e mirë dhe s' kanë pse t'i pyesin prindërit'. Këto qëndrime mund të bëhen pengesa për një komunikim të mirë, prandaj preferohet që edukatroja që në fillim të bisedojë me familjen dhe t'iu shpjegojë se ajo e ndjen nevojën për informacionin e familjes. Prandaj preferohet që edukatroja të përdorë metoda të ndryshme për të krijuar një atmosferë të volitshme të takimit me prindër, që nxitë pjesmarrjen aktive të prindërve në diktatim.

Një raport i mirë fëmijë-prind-edukatore ndikon që ai të ndihet i kënaqur dhe i sigurt, dhe për këtë arsye nevojitet një bashkëpunim i frytshëm mes familjes dhe institucioneve parashkollore që ta përmbushin rolin e tyre edukativ dhe të arrihet një përshtatje sa më e lehtë e fëmijës më jetën në kopsht.

Për realizimin e këtij studimi do të analizoj, 'Ligjin mbi edukimin parashkollor', standardet e përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë (3-6 vjeq), dhe literaturë tjetër relevante, po ashtu intervista me persona përgjegjës të këtij relacioni dhe anketa me prindër dhe edukatore.

Gjilan, Data 22/03/2015

Nënshkrimi i kandidatit